

VENDIM
Nr. 217, datë 11.3.2015

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 8.4.2014, PËR ÇËSHTJEN “KARAGJOZI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR ANKIMET NR. 25408/06, 37419/06; 49121/06; 1504/07; 19772/07; 46685/07; 49411/07; 27242/08; 61912/08 DHE 15075/09)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet: nr. 25408/06 (Karagjozi dhe të tjerë); nr. 49121/06 (Koco); nr. 19772/07 (Shehu); nr. 46685/07 (Dovrani dhe Dume); nr. 49411/07 (Sallabanda dhe Hoxha); nr. 27242/08 (Goga dhe të tjerë); nr. 61912/08 (Tartari) dhe nr. 15075/09 (Okaj), sipas listës së ankuesve në shtojcën 1, dhe shumat e përcaktuara në shtojcat 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për secilën çështje.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve: Karagjozi dhe të tjerë (nr. 25408/06); Koco (nr. 49121/06); Shehu (nr. 19772/07); Dovrani dhe Dume (nr. 46685/07); Sallabanda dhe Hoxha (nr. 49411/07); Goga dhe të tjerë (nr. 27242/08); Tartari (nr. 61912/08) dhe Okaj (nr. 15075/09), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i Ministrisë së Financave, brenda një afati 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, AKKP-ja dhe Ministria e Financave që, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (ankimet nr. 25408/06, nr. 37419/06; nr. 49121/06; nr. 1504/07; nr. 19772/07; nr. 46685/07; nr. 49411/07; nr. 27242/08; nr. 61912/08 dhe nr. 15075/09), është bërë përfundimtar, të ekzekutojnë, në favor të ankimit 37419/06 (Budini), vendimin nr. 43, datë 28.3.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Mat, për kompensimin e sipërfaqes 3 178 m² me obligacione.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe AKKP-ja që, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 8.4.2014, për çështjen “Karagjozi dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (ankimit nr. 25408/06, nr. 37419/06; nr. 49121/06; nr. 1504/07; nr. 19772/07; nr. 46685/07; nr. 49411/07; nr. 27242/08; nr. 61912/08 dhe nr. 15075/09) është bërë përfundimtar, të ekzekutojnë, në favor të ankimit nr. 1504/07 (Hajnaj), vendimin nr. 1016, datë 28.12.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të ndryshuar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 3847, datë 15.7.2004.

8. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Financave, në programin “Ekzekutimi i pagesave të ndryshme”.

9. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1 – LISTA E APLIKANTËVE

Nr.	Emri dhe numri i aplikimit	Emri i aplikantit(ve) (viti i lindjes)	Shteti i vendbanimit	Përfaqësuar nga	Data e prezantimit
1.	Karagjozi dhe të tjerë nr. 25408/06	Pëllumb Karagjozi (1936) Halim Karagjozi (1941) Sibo Karagjozi (1933) Sezar Babameto (1928) Eqerem Babameto (1929) Aila Babameto (1939) Bardha Kokona (1946) Genti Kokona (1983) Redrina Kokona (1976) Briseida Kokona (1954) Endri Shuke (1984) Tefik Kokona (1942) Arben Dedei (1967)	Shqipëri	S. Puto, avokat	13 qershor 2006
2.	Budini, nr. 37419/06	Bajram Budini (1942)	Shqipëri	V. Muzina, avokat	31 gusht 2006
3.	Koco, nr. 49121/06	Gjenci Koco (1936)	Shqipëri	S. Puto, avokat	1 dhjetor 2006
4.	Hajnaj, nr. 1504/07	Veliko Hajnaj (1963)	Shqipëri	T. Jorgji, Z. Gani, D. Kruja, avokat	25 dhjetor 2006
5.	Shehu, nr. 19772/07	Agim Shehu (1952) Petrut Shehu (1957) Bardhyl Shehu (1937) Sanie Bakalli, née Shehu (1934)	Shqipëri	S. Puto, avokat	3 maj 2007
6.	Dvorani dhe Dume, nr.46685/07	Valter Dvorani (1952) Shpetim Dvorani (1938) Pranvera Dvorani (1954) Diana Dvorani (1958) Gurie Dvorani (1925) Svjetlana Dume (1949) Besa Dume (1952) Fatbardha Dume (1954)	Shqipëri	S. Puto, avokat	9 tetor 2007
7.	Sallabanda dhe Hoxha, nr. 49411/07	Virgil Sallabanda (1933) Meri Hoxha (1937) Afërdita Sallabanda (1946)	Shqipëri	A. Tartari, avokat	25 tetor 2007
8.	Goga dhe të tjerë, nr. 27242/08	Çezar Goga (1955) Kristaq Goga (1917) Kostandina Goga (1925) Aleksander Goga (1948) Ilira Gjika, née Goga (1955) Olimbia Goga (1931) Stavri Paço (1952) Mirsa Paço (1983) Danila Paço (1990) Sofia Goga (1916) Afërdita Jani, née Goga (1948) Ansi Kromidha, née Goga (1938) Dorian Goga (1973) Sonila Serdani, née Goga (1977) Viktor Noçka (1935) Albert Noçka (1952)	Shqipëri dhe Itali	S. Puto, avokat	3 qershor 2008

9.	Tartari, nr. 61912/08	Fatos Tartari (1938)	Shqipëri	A. Tartari, avokat	24 nëntor 2008
10.	Okaj, nr. 15075/09	Gazmend Okaj (1961) Fadil Okaj (1934) Vjollca Okaj (1958) Ardiana Okaj (1965)	Shqipëri	B. Muslija, avokat	7 mars 2009

SHTOJCA 2 – DËMI MONETAR DHE JOMONETAR

Nr.	Emri dhe nr. i aplikimit	Dëmi monetar dhe jomonetar
1.	Karagjozi dhe të tjerë nr. 25408/06	1,092,600 euro (një milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind euro).
2.	Budini, nr. 37419/06	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
3.	Koco nr. 49121/06	750,500 euro (shtatëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind euro).
4.	Hajnaj, nr. 1504/07	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
5.	Shehu, nr. 19772/07	205,000 euro (dyqind e pesë mijë euro, për sa ka të bëjë me pjesën e aplikantit).
6.	Dvorani dhe Dume, nr. 46685/07	54,800 euro (pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind euro).
7.	Sallabanda dhe Hoxha, nr. 49411/07	3,589,600 euro (tre milionë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë e gjashtëqind euro).
8.	Goga dhe të tjerë, nr. 27242/08	1,120,000 euro (një milion e njëqind e njëzet mijë euro).
9.	Tartari, nr. 61912/08	521,000 euro (pesëqind e njëzet e një mijë euro).
10.	Okaj, nr. 15075/09	820,500 euro (tetëqind e njëzet mijë e pesëqind euro).

SHTOJCA 3 – KOSTOT DHE SHPENZIMET

Nr.	Emri dhe nr. i aplikantit	Kostot dhe shpenzimet
1.	Karagjozi dhe të tjerë nr. 25408/06	1,650 euro (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro).
2.	Budini, nr. 37419/06	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
3.	Koco, nr. 49121/06	1,450 euro (një mijë e katërqind e pesëdhjetë euro).
4.	Hajnaj, nr. 1504/07	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
5.	Shehu, nr. 19772/07	1,550 euro (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë euro).
6.	Dvorani dhe Dume, nr. 46685/07	1,650 euro (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë euro).
7.	Sallabanda dhe Hoxha, nr. 49411/07	400 euro (katërqind euro).
8.	Goga dhe të tjerë, nr. 27 242/08	1,100 euro (një mijë e njëqind euro).
9.	Tartari, nr. 61912/08	Asnjë (nuk u bë asnjë ankesë).
10.	Okaj, nr. 15075/09	1,200 euro (një mijë e dyqind euro).